



Leksion i Hapur

Titulli : Ndërgjegjësimi për sigurinë kibernetike dhe shkeljen e të dhënave personale për studentët e Universitetit të Tiranës.

Lektorët: Dr. Eyal Pinko, Blerta Xhako dhe Saimir Kapllani

Data dhe ora 31/10/2022 12:00 - 14:15

Vendi: Salla Aula Magna, Godina Liria

Studentët e Universitetit të Tiranës, lundrojnë në internet çdo ditë për punë dhe kënaqësi - për të kërkuar informacion për detyrat e tyre të kursit, esetë dhe temën e diplomës por edhe, për të qenë në kontakt përmes mediave sociale me studentë të tjerë apo punëdhënës, për të bërë blerje në internet apo dhe argëtuar.

Sasia e madhe e informacionit dhe e të dhënave që ndajmë në internet na përball të gjithëve me kërcënimet e sigurisë kibernetike. Rreziku është më i theksuar për të rinjtë, të cilët statistikisht kanë më shumë gjasa të bien pre e mashtrimeve sesa të tjerët pasi i përdorin mediat sociale më shpesh se grup moshat e tjera. Kriminelët dhe hakerët modernë kibernetikë përdorin mjete gjithnjë e më të sofistikuar për të hyrë në të dhënat tona më të ndjeshme dhe informacionin personal. Shërbimet e njohura si Wi-Fi falas dhe kompjuterët publikë mund të çojnë në kompromis të të dhënave, humbje financiare dhe vjedhje identiteti. Pra i gjithë digjitalizimi i jetës tonë na përball me rreziqe shumë të mëdha.

Pavarësisht nëse jeni në vitin e parë bachelor apo të fundit të studimeve master, nuk është kurrë vonë për të marrë disa këshilla dhe informacion për sigurinë në internet, për ruajtjen e të dhënave personale dhe për të rritur ndërgjegjësimin tuaj për sigurinë kibernetike. Mënyra më e mirë për të mbrojtura nga sulmet kibernetike dhe shkelja e të dhënave personale është përmes parandalimit dhe informimit.

Bibliografia e Lektorëve

1. Dr. Eyal Pinko ka një diplomë në Bachelor me standard të lartë në Inxhinieri Elektronike dhe tre Diploma Master me standarde të larta në Shkenca Politike, Menaxhim Publik dhe Zhvillim Organizativ. Ai është i diplomuar në Kursin Kombëtar të Inteligjencës së Lartë dhe kurse të tjera të specializuara të trajnimit të inteligjencës. Në vitin 2019 ai mbrojti me





- sukses doktoraturën e tij, në fushën e Studimeve të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Universitetin Bar-Ilan, Izrael. Dr. Pinko është drejtuese i programit Master në “Strategji, Inteligjencë dhe Siguri Kibernetike” në të njëjtin universitet. Për më shumë se dy vjet ai ka qenë një konsulent i lartë në Drejtorinë Kombëtare Kibernetike të Izraelit. Aktualisht ai është edhe Drejtor Ekzekutiv në “Terra Strategic Solutions” dhe President në “Institutin Ndërkombëtar për Kërkimin e Migracionit dhe Sigurisë”. Dr. Pinko ka qenë folës kryesor në shumë konferenca kibernetike në mbarë botën. Ai është gjithashtu një studiues i vjetër në disa “think-tank” ndërkombëtare, duke qenë autor i më shumë se 200 artikujve të botuar në anglisht dhe hebraisht.
2. Blerta Xhako mban pozicion e Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Integritimit pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prej shkurtit 2018. Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2011. Znj. Xhako është licencuar në profesionin e avokatit prej vitit 2013 pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në karrierën e saj ka ushtruar profesionin e avokatit, koordinatorit në Kryeministri si dhe ka mbajtur postin e Drejtorit të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike pranë Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Znj. Xhako ka kryer disa trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën e jurisprudencës, si dhe të menaxhimit në administratën publike, certifikuar dhe nga shkolla e administratës publike franceze “Ecole Nationale D’Administration”.
 3. Saimir Kapllani është ekspert ligjor me një eksperiencë më shumë se 13 vjeçare në administratën publike. Ekspertiza e tij gjatë këtyre viteve është fokusuar në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së kuadrit ligjor në fushën e Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike. Prej 4 vitesh ai mban pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ku është përgjegjës për kontrollin e implementimit të masave të sigurisë kibernetike nga Infrastrukturat Kritike të Informacionit dhe gjithashtu mbikëqyrjen e veprimtarisë së Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Saimiri ka përfunduar studimet e larta në fushën e Drejtësisë, ku është diplomuar në Master Shkencor dhe gjithashtu ka përfunduar Master Profesional në “EU Business Law”. Gjate karrierës së tij është certifikuar dhe kualifikuar me trajnime të ndryshme profesionale, si : Certified Lead Auditor për standartin ISO 27001 (Menaxhim i sigurisë së informacionit) Cyber Security Studies pranë George C. Marshall (Qendra Evropiane për studimet e Sigurisë) , etj.

Gjeni më poshtë programin e këtij leksioni të hapur.





Programi i aktivitetit

ORA 12:00 - 13:00: Leksion i Hapur: “ Ndërgjegjësimi për sigurinë kibernetike për studentët e Universitetit të Tiranës ”

Salla Aula Magna, Godina Liria

Më pjesëmarrjen online të Dr. Eyal Pinko

Me pjesëmarrjen fizike të Z. Saimir Kapllani

12:00-12:30 Kërcënimet kibernetike për sigurinë kombëtare: Rreziku, sfidat dhe mekanizmat e zbutjes

12:30-12:45 Disa këshilla sigurie për studentët

12:45- 13:15 – Kuadri ligjor i sigurisë kibernetike në Shqipëri- Roli i Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik.

13:15-13:30 Pyetje dhe diskutime

ORA 13:30-14.15: Seminar Informues: “Mbrojtja e të dhënave personale”

Salla Aula Magna, Godina Liria

Më pjesëmarrjen fizike të Znj. Blerta Xhako

13.30-14.00 E drejta e aksesit në të dhënat personale- Kuadri rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave

14.00-14.15 Pyetje dhe diskutime

